



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 04

Datë: 07. 02. 2020. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniqi, Nenad Rikallo, Artan Asllani, Čemailj Kurtişi.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së,
2. Miratimi i Rekomandimit për Presidentin e Republikë së Kosovës, lidhur me kandidatët e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevë dhe Vushtri;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim- ndryshimit për përshkrimin e vendit të punës për pozitën: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve;
5. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Përshëndetje. Së pari, ju uroj mirëseardhje anëtarëve të ri në të KQZ-së, në anën tjetër, a ka dikush vërejtje, propozime lidhur me rendin e ditës...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës pa vërejtje. Pastaj, anëtarët e KQZ-së, shqyrtuan rekomandimin e Presidentit të Republikë së Kosovës, lidhur me zëvendësimin e kandidatëve që janë në radhë për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Miratimi i Rekomandimit për Presidentin e Republikë së Kosovës, lidhur me kandidatët e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës

E kemi rekomandimin, tha znj. Daka, e cila, shpjegoi faktin se, zëvendësimi bëhet mbi bazën e legjislacionit në fuqi, bazuar në praktikën e deritashme.

Sami Kurteshi, tha se, në listë janë emrat – kush duhet të zëvendësohet dhe se, çështja është se si bëhet zëvendësimi ! Zëvendësimi bëhet sipas nenit 112, paragrafi 2 dhe paragrafi 4. Në bazë të nenit, thuhet që gjinia është kategoria përcaktuese për zëvendësim! Sipas analizës sime, tha z. Kurteshi, kjo është në kundërshtim me kushtetutën, në frymën e legjislacionit në Kosovë, madje edhe me kërkesën për barazi gjinore. Sipas këtij paragrafi, dhe ligjeve të tjera që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, pra kuota merret si pragu që, nuk mund të kalohet nën te ! Synimi pra, është që të bëhet diskriminimi pozitiv në të gjitha institucionet shtetërore, tha z. Kurteshi. Në vazhdim, pas një analize të thelluar të kësaj çështje, z. Kurteshi konstatoi se, nëse çdo vendim që do të shkonte vetëm sipas gërmës së ligjit për zgjedhjet (neni 112), dhe të zgjidhej, nëse eventualisht është radha: një kandidat mashkull është heqë nga lista e deputetëve dhe, kërkohet të silllet me çdo kusht një mashkull, por është një femër, kjo mund të jetë shkelje ! Pra, mendoj se ky nen, është i interpretuar gabimisht, tha z. Kurteshi.

Kryetarja **Daka**, tha se, është i kuptueshëm diskutimi por, si KQZ – ja është e lidhur me ligjin, dispozita është e qartë dhe nuk lë vend për ndonjë interpretim tjetër. Ajo, lexoi ligjin në fjalë, dhe konstatoi përcaktimet e ligjit, kush – kënd e zëvendëson...! Ne, vazhdoi zonja Daka, jemi të obliguar ta zbatojmë ligjin, dhe se KQZ nuk ka mundësi ta ndryshoj ligjin, dhe as të marrë ndonjë vendim që bie ndesh me ligjin.

Në fund, znj. Daka, tha se KQZ bëjmë rekomandimin për Presidencës, dhe se nuk marrim ndonjë vendim...

Alim Rama, kërkoi që të merret parasysh çështja e ngritur nga z. Samiu. Ligji në bazë, tha se është në kundërshtim me vetë ligjin: e përcakton kuotën gjinore, dhe në të njëjtën kohë e kufizon, tha z. Alimi.

Në vazhdim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, **Arianit Elshani**, kërkoi që të vazhdohet më tutje, sepse ndryshimi është në mandatin e parlamentarëve dhe, jo të KQZ-së. Pra, zëvendësimi të bëhet në bazë të gjinisë së njëjtë, sepse ligji diskriminon pozitivisht të dy gjinitë...

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së miratuan rekomandimin për zëvendësimin e kandidatëve të radhës:

Nga lëvizja “VETËVENDOSJE!”:

1. Enver Haliti, e zëvendëson Albin Kurtin,
2. Alban Hyseni, e zëvendëson Glauk Konjufcën,
3. Arta Bajralija, e zëvendëson Albulena Haxhiun,

4. Fitim Haziri, e zëvendëson Arben Vitia,
5. Eman Rrahmani, e zëvendëson Haki Abazin.

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës:

1. Hatim Baxhaku, e zëvendëson Anton Qunin,
2. Fidan Rekaliu, e zëvendëson Lumir Abdixhikun,
3. Xhavit Uka, e zëvendëson Avdullah Hotin,
4. Besa Gaxherri, e zëvendëson Hykemete Bajramin,
5. Shkumbin Gashi, e zëvendëson Besian Mustafën.

Nga Nova Demokratska Stranka:

1. Zikreta Aliti, e zëvendëson Emilija Redžepin.

Valdete Daka: Kush është për këtë rekomandim ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për Presidentin e Republikë së Kosovës, lidhur me kandidatët e radhës për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me 9 vota për dhe 2 abstenime.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevë dhe Vushtrri

Valdete Daka: I gjithë dokumentacioni është në rregull, prandaj kush është për që, znj. Mimoza Sublla - Abdullahu, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Podujevë nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtaren e deritashme, znj. Filloreta Zejnullahu.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht këtë zëvendësim.

Kush është për që, znj. Suzana Syla të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Vushtrri nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtaren e deritashme, znj. Rrezarta Krasniqi.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht këtë zëvendësim.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim- ndryshimit për përshkrimin e vendit të punës për pozitën: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve

Valdete Daka: Në këtë pikë të rendit të ditës, e kemi vendimin e këshillit për personel. Pra, të ish këshillit...! Për një kohë të gjatë, e kemi këtë pozitë të pa përmbushur, pra duhet që ta plotësojmë...

Sami Kurteshi: E kam lexuar me kujdes materialin, dhe pajtohem me hapjen por kam vërejtje në kufizimin lidhur me specifikimin e mundësisë që të mundësohet pjesëmarrja edhe e kandidatëve të tjerë të fushave të tjera..

Në këtë pikë, bëri shpjegime kryetarja Daka që e konsideroi si të plotë hapësirën e pjesëmarrjes...

Eshref Vishi, tha se, në shkresat e kësaj lënde të rendit të ditës po e vërej që ka të bëj me plotësim – ndryshimin e rregullores 02/2017 për përshkrimin e detyrave të punës dhe klasifikimin e vendeve të punës në SKQZ. Praktikisht po them që do të kishte qenë mirë që të mos vie si rekomandim vetëm për plotësim – ndryshimin e përshkrimit të vendit të punës, mirëpo le të vie si propozim për ndryshimin e rregullores. Me vendime, ne nuk mund të bëjmë ndërhyrje në rregulloret që i ka KQZ, tha z. Vishi.

Sami Hamiti, tha se, ne e kemi një plan një rishikim të rregulloreve, sepse i kemi 5 – 6 raste të zyrtarëve komunal që kanë mbetur të pazgjdhura...! Këtu, rregulloret nuk mund të rishikohen shpejt, mirëpo kjo le të shkoj, dhe në pjesën e parë të vitit t'i shikojmë rregulloret...

Në vazhdim, në këtë pikë foli **Nexhmedin Hyseni** (SKQZ), i cili tha se konkursi është i bazuar në rregulloren, përkatësisht në nenin 9, pastaj: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Valdete Daka, Alim Rama dhe Arianit Elshani.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan ndryshim – plotësimet për përshkrimin e vendit të punës për pozitën: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve, me 10 vota për, dhe një votë abstenim...

1. **Të ndryshme.**

Valdete Daka: Ju jeni në dijeni se, janë shpallur zgjedhjet në Podujevë nga Presidenti me 15 mars, dhe se, nga ky moment fillojnë të rrjedhin afatet ligjore. Ne, siç e dini ne përgatisim disa draft vendime, dhe se, të mobilizohemi që të takohemi sot përsëri...Sekretariati le t'i përgatitë materialet...